



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 31.12.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti Nr.APK-DPKI-06-1416/24, për zyrtarin e lartë z. Nuhija Tairovci, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Dragashit, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik.

A r s y e t i m

Rasti i hapur (sipas një raportimi) nën dyshimin për papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Nuhija Tairovci, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi ishte raportuar se z. Nuhija Tairovci, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publike, respektivisht Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Dragashit, i njëjti në të njëjtën kohë është Drejtor i Organizatës Joqeveritare Bošnjacka Zajednica Kulture "Preporod" në Dragash.

Më pas, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka dërguar shkresën zyrtare DPKI-06-01/41624, duke e njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së papajtueshmërisë në ushtrimi e funksionit publik. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtura një takim në zyrat e Agjencisë, me ç' rast zyrtari në fjalë është njoftuar me pretendimet e ngritura për situatën e mundshme të konfliktit të interesit respektivisht papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik, njëherëit i është bërë me dije se gjatë ushtrimit të funksionit publik në cilësinë e zyrtarit të lartë publike, ai nuk mund që njëkohësisht të mbajë funksion drejtues e as të jetë përfaqësuese i autorizuar në Organizatën Joqeveritare(OJQ), sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë

ne ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Pas sqarimit dhe diskutimit të fakteve, zyrtari i lartë është pajtuar me gjetjet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, duke deklaruar: Mars të vitit 2022, jam emëruar Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Dragashit, që nga ajo kohë si OJQ BZK “Preporod” nuk kemi pas asnjë aktivitet d.m.th. nuk kemi qenë aktive. Komuna e Dragashit ka pasur konkurse për organizimin “Ditët e Diasporës”, në të cilin konkurs kanë aplikuar 4 apo 5 OJQ, mirëpo ne si OJQ nuk kemi marrë pjesë dhe nuk kemi qenë përfitues.

Sa i përket pretendimit të ngritur për konflikt të interesit, se z. Tairovci si i emëruar politik dhe person i autorizuar në një OJQ, ka marrë pjesë në manifestimin e organizuar “Ditët e Diasporës”, Agjencia bazuar në dokumentacion ne dispozicion (*vendim i dt. 16.05.2024, komisionit vlerësues të Komunes së Dragashit*), sqaron se OJQ në të cilën z. Tairovci ka qenë përfaqësues i autorizuar, nuk ka marrë pjesë në thirrjen publike të Komunes së Dragashit, datë 04.04.2024, si dhe nuk është shpallur fitues i subvencionit për manifestimin “Ditët e Diasporës”, ashtu siç pretendon raportues i rastit.

Gjithashtu, pas sqarimeve të dhëna në Agjenci lidhur me papajtueshmërinë në ushtrim e funksionit publik, zyrtari i lartë është zotuar se ne afatin sa me te shpejt do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmangë papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik, duke hequr dorë nga përfaqësuesi i autorizuar (OJQ).

Ndërkohë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është njoftuar nga z. Tairovci se janë bërë ndryshimet e kërkuara në OJQ-në, në fjalë, të cilat dëshmojnë edhe përmes shkresës zyrtare “Letërkonfirmim”, ku i njëjti nuk figuron më të jetë Kryetare e as Përfaqësues i Autorizuar në OJQ-në *Bošnjačka Zajednica Kulture “Preporod”* në Dragash.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit